



## DEKLARATË PRELIMINARE

### Zgjedhjet parlamentare të 9 shkurtit – në harmoni me standardet ndërkombëtare

*Prishtinë, 10 shkurt 2025*

#### PËRMBLEDHJE E GJETJEVE KRYESORE

---

Koalicioni i organizatave vendore për vëzhgimin e zgjedhjeve, Demokracia në Veprim, vlerëson se zgjedhjet parlamentare të 9 shkurtit u zhvilluan në përputhje me standardet demokratike për zgjedhje të lira, konkurruese dhe të drejta. Administrimi i operacioneve zgjedhore ishte përgjithësisht i rregullt, përjashtuar procesin e publikimit të rezultateve dhe numërimit të votave për kandidatët;

Procesi i votimit dhe numërimit gjatë ditës së zgjedhjeve, është zhvilluar përgjithësisht në një atmosferë të qetë dhe demokratike, i karakterizuar nga një interesim relativisht të lartë të votuesve për të marrë pjesë në zgjedhje. Megjithatë, procesi i votimit është shoqëruar me disa parregullsi dhe shkelje, kryesisht të natyrës procedurale. Nuk është raportuar për incidente serioze gjatë votimit që do të mund të cenonin integritetin e zgjedhjeve;

Problemet teknike me sistemin elektronik të publikimit të rezultateve të KQZ-së, të shfaqura vetëm disa orë pas përfundimit të votimit, krijuan konfuzion dhe ulën besimin e publikut në transparencën e procesit. Kjo situatë la një impakt negativ në perceptimin për organizimin zgjedhor;

Është për t'u përshëndetur qasja vetpërbajtëse e subjekteve politike kryesore, që pas përfundimit të votimit, përkundër problemeve me sistemin elektronik të publikimit të rezultateve, i kanë njohur dhe pranuar në mënyrë të qetë rezultatet preliminare të zgjedhjeve për subjektet politike;

Numërimi i votave për kandidatët në Qendrat Komunale të Numërimit nuk ka nisur ende për shkak të problemeve teknike, ndonëse ligjërisht parashihet që duhet të fillonte në orën 08:00 të mëngjesit të sotëm. Këto vonesa mund të kenë ndikim negativ në integritetin e procesit dhe të shkaktojnë shtyrje në certifikimin e rezultateve;

Fushata zgjedhore për këto zgjedhje ishte e para me një kohëzgjatje të plotë prej 30 ditësh, duke sjellë një ritëm të lartë të aktiviteteve zgjedhore dhe një angazhim të shtuar të subjekteve politike në terren dhe në hapësirën digjitale – në të cilën, për këtë fushatë 30 ditore, është shënuar shifër rekord e shpenzimeve prej 200 mijë eurosh nga subjektet politike dhe kandidatët e tyre;

Mungesa e rregullimit ligjor për aktivitetet e parafushatës zgjedhore krijoi një hapësirë të pakufizuar për angazhim paraelektoral të partive politike në Kosovë, duke krijuar edhe mundësinë për shmangie të raportimeve financiare dhe sanksioneve gjatë kësaj periudhe;

Fushata zgjedhore ishte dinamike, atraktive dhe programore. Ndërsa, diskursi politik gjatë fushatës ishte i ashpër, veçanërisht nga partia në pushtet, çka rezultoi në një numër rekord të gjobave të shqiptuara nga PZAP-ja, me një vlerë të përgjithshme mbi 600 mijë euro;

Votimi jashtë vendit ishte operacioni më i prekur nga ndryshimet e fundit ligjore, duke i zgjeruar mundësitë e votimit për qytetarët në diasporë edhe fizikisht në misione diplomatike, por edhe me postë në fahet postare jashtë vendit. Interesimi i qytetarëve jashtë vendit për të votuar ishte i lartë, me mbi 100 mijë votues të regjistruar për të votuar;

Sipas të dhënave të fundit, numri i përgjithshëm i zarfeve me fletëvotime të pranuar nga kutitë postare jashtë Kosovës dhe të konfirmuara nga shërbimi postar deri më 7 shkurt ishte 50,226, ndërsa në Kosovë kanë arritur 40,859 prej tyre;



Votimi jashtë vendit u karakterizua me ndërhyrje politike të Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Diasporës (MPJD), në pothuajse të gjitha fazat e tij. Dështimet dhe problemet me transportimin e votave, kanë ngritur dyshime lidhur me sigurinë dhe integritetin e këtij procesi;

Procesi vendimmarrës i trupave menaxhuese zgjedhore ishte përgjithësisht konsensual, ndonëse për disa çështje të ndjeshme pati përplasje mes anëtarëve, sidomos ndërmjet përfaqësuesve të partisë në pushtet dhe të tjerëve;

Edhe pse këto zgjedhje ishin të rregullta sa i përket kalendarit kohor, duke i dhënë KQZ-së më shumë kohë për planifikim dhe ekzekutim, janë shënuar vonesa në disa procese kyçe, përfshirë miratimin e përbërjes së komisioneve komunale zgjedhore, krijimin e qendrave komunale të numërimit dhe publikimin e qendrave të votimit jashtë vendit;

Një nga sfidat teknike kryesore të këtyre zgjedhjeve ishte çështja e ngjyrës matrikuluese. Procesi i tenderimit për këtë material u shoqërua me vonesa dhe probleme cilësore, të cilat rezultuan me raportime për fshirje të lehtë të saj nga gishtat e votuesve. Për më tepër, vetë përdorimi i matrikulimit si metodë për shënimin e votuesve u kritikua nga organizatat e shoqërisë civile dhe Agjencia për Informim dhe Privatësi, të cilat e konsideruan atë si shkelje të fshehtësisë së votës;

Gjatë organizimit të zgjedhjeve, KQZ mori disa vendime që u kritikuan për cenimin e fshehtësisë së votës. Një prej tyre ishte vendosja e kabinave të votimit në pozita ballore, e cila u konsiderua problematike pasi rrezikonte ekspozimin e preferencave të votuesve. Ky vendim u ndryshua pas presionit nga shoqëria civile. Për të rritur transparencën dhe parandalimin e manipulimeve, KQZ vendosi të shfrytëzojë kamera në vendvotime për regjistrimin e procesit zgjedhor;

Gjatë fushatës zgjedhore, peizazhi mediatik ishte i polarizuar, duke u karakterizuar nga dy zhvillime kryesore: partia në pushtet mbajti një qasje vazhdimisht konfrontuese ndaj gazetarëve, ndërsa disa media u perceptuan si të njëanshme në mbulimin dhe raportimet e tyre;

Në këto zgjedhje, aplikuan për certifikim 28 subjekte politike me gjithsej 1,280 kandidatë. Në përgjithësi, KQZ miratoi aplikacionet e të gjitha subjekteve, me përjashtim të Listës Serbe, vendimi për të cilën shkaktoi debat të gjerë dhe ngriti shqetësime mbi qasjen e barabartë në garën zgjedhore. Në këtë rast, kundërligjshëm refuzoi certifikimin e saj, pavarësisht rekomandimit të Zyrës për Regjistrimin e Partive Politike. Më vonë, Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP) dhe Gjykata Supreme vendosën për certifikimin e këtij subjekti, duke e korrigjuar vendimin fillestar të KQZ-së, duke shfaqur dominimin e konsideratave politike mbi parimet ligjore në disa aspekte të administrimit të zgjedhjeve;

Zgjedhjet parlamentare të 9 shkurtit 2025 u monitoruan nga një numër i konsiderueshëm vëzhguesish, duke përfshirë përfaqësues të partive politike, organizatave të shoqërisë civile, misioneve ndërkombëtare dhe mediave. Në total, mbi 20,000 vëzhgues u akredituan për të mbikëqyrur mbarëvajtjen e procesit zgjedhor në të gjitha nivelet.



## Konteksti politik i zgjedhjeve për Kuvendin e Kosovës

---

Zgjedhjet parlamentare të 9 shkurtit 2025 shënuan herën e parë që Kosova organizoi zgjedhje të rregullta që nga shpallja e pavarësisë në vitin 2008, duke i bërë ato të gjashtat me radhë. Për herë të parë, një qeveri e zgjedhur në mënyrë demokratike përfundoi mandatin e saj të plotë katërvjeçar, megjithëse periudha e saj e qeverisjes u shoqërua me sfida të shumta të brendshme dhe të jashtme. Qeveria e dalë nga zgjedhjet e vitit 2021, e udhëhequr nga Lëvizja Vetëvendosje (LVV), e cila fitoi mbi 50% të votave, pati vështirësi të vazhdueshme në sigurimin e kuorumit parlamentar për vendimmarrje.

Disa çështje kyçe, si reforma në drejtësi dhe miratimi i Kodit Civil, krijuan tensione të brendshme që çuan në largimin e disa deputetëve nga grupi parlamentar i partisë në pushtet. Këto zhvillime jo vetëm që ekspozuan fragmentimin brenda strukturave qeverisëse, por gjithashtu theksuan sfidat e menaxhimit të pluralizmit politik dhe ruajtjes së stabilitetit qeverisës, veçanërisht kur mbështetja e saj varej nga partitë e vogla multietnike.

Në politikën e jashtme, qeveria vazhdoi procesin e dialogut me Serbinë, duke përfunduar Marrëveshjen e Ohrit, e cila shtoi presionin ndërkombëtar për zbatimin e marrëveshjeve të mëparshme, përfshirë themelimin e Asociacionit të Komunave me Shumicë Serbe. Ky proces, megjithëse i promovuar nga aktorët ndërkombëtarë, u prit me kundërshtime të mëdha në skenën politike të brendshme, duke nxitur debate dhe polarizim.

Në veri të Kosovës, tensionet u përshkallëzuan gjatë mandatit të qeverisë, duke kulmuar me dorëheqjen masive të përfaqësuesve politikë dhe administrativë të komunitetit serb nga institucionet publike. Këto zhvillime krijuan një boshllëk institucional në atë pjesë të vendit dhe përshkallëzuan sfidat në integrimin e këtij komuniteti në sistemin politik dhe administrativ të Kosovës. Situata u rëndua më tej me sulmin e rëndë terrorist në Banjskë në shtator 2023, i cili, sipas institucioneve vendore dhe partnerëve ndërkombëtarë, u orkestrua nga struktura të lidhura me qeverinë serbe dhe zyrtarë të Listës Serbe.

Zgjedhjet parlamentare u zhvilluan në këtë kontekst politik të ndërlikuar, të karakterizuar nga përplasjet mbi qeverisjen, marrëdhëniet ndëretnike dhe sfidat e integritetit euroatlantik të vendit. Këta faktorë ndikuan në debatin politik dhe në atmosferën e përgjithshme të fushatës, duke ndikuar edhe në diskursin dhe narrativat kryesore të akterëve politik gjatë garës zgjedhore.

## Korniza ligjore

---

Sistemi zgjedhor për zgjedhjet parlamentare në Kosovë rregullohet nga Kushtetuta dhe një sërë ligjesh specifike, të cilat përcaktojnë administrimin dhe funksionimin e zgjedhjeve. Ligji i ri për Zgjedhjet e Përgjithshme, i miratuar në qershor 2023, sjell disa ndryshime në kuadrin ekzistues, ndërsa Ligji për Financimin e Subjekteve Politike, i rishikuar në qershor 2022, përcakton rregullat për transparencën dhe kontrollin e financimit të partive. Kodi Penal i Republikës së Kosovës dhe rregullat e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ) janë gjithashtu komponentë kyç të kornizës ligjore.

Sistemi zgjedhor mbetet proporcional me lista të hapura, ku Kosova funksionon si një zonë e vetme zgjedhore për 120 ulëset në Kuvend. Nga këto, 10 ulëse janë të garantuara për subjektet që përfaqësojnë komunitetin serb dhe 10 të tjera për komunitetet e tjera jo-shumicë. Pragu zgjedhor është 5% për të gjitha subjektet politike, përfshirë partitë, koalicionet apo iniciativat qytetare. Pragu zgjedhor nuk aplikohet për ato që garojnë për ulëset e garantuara.

Pavarësisht pritshmërive për një reformë më të thelluar, ndryshimet e miratuara në vitin 2023 u përqendruan kryesisht në çështje teknike të administrimit të zgjedhjeve. Një numër çështjesh kyçe për avancimin e demokracisë dhe garantimin e integritetit të zgjedhjeve mbetën të paadresuara. Për më tepër, disa ndryshime të miratuara kanë ngritur shqetësime serioze për ndikimin e tyre potencial në integritetin e procesit zgjedhor.



Ndër ndryshimet më esenciale ishin zgjerimi i mundësive të votimit për qytetarët që jetojnë jashtë vendit, përmes shtimit të votimit fizik në misione diplomatike si dhe votimit me postë në fahet postare të misioneve diplomatike. Po ashtu, pati edhe ndryshime sa i përket numërimit të votave të kandidatëve të subjekteve politike, të cilat tashmë do të numërohen në Qendra Komunale të Numërimit, e jo në vendvotim.

Një ndër ndryshimet më të diskutueshme ishte ulja e standardit për përshtatshmërinë juridike të kandidatëve. Tani, ndalesa për kandidim aplikohet vetëm për ata që janë dënuar me burgim efektiv mbi një vit, duke hapur rrugën për pjesëmarrjen në zgjedhje të personave të dënuar me kusht ose me gjobë, përfshirë ata të dënuar për vepra penale të ndërlidhura me korrupsionin. Duke qenë se në vitet e fundit shumica e rasteve të korrupsionit janë dënuar me masa alternative, ky ndryshim mund të ndikojë negativisht në cilësinë dhe integritetin e përfaqësimit politik në Kuvendin e Kosovës.

Një tjetër ndryshim i rëndësishëm ishte rikthimi i modelit të votimit preferencial me 10 kandidatë, siç ishte praktikuar në zgjedhjet e vitit 2007. Ndërsa synimi ishte zgjerimi i mundësive për votuesit, ky ndryshim bart rreziqe në lidhje me efikasitetin e procesit të numërimit dhe rritjen e mundësive për manipulime në vendvotime, veçanërisht kur votuesit nuk shfrytëzojnë të gjitha opsionet e tyre për 10 kandidatë. Përveçse zgjat ndjeshëm procesin e numërimit, rritja e votës preferenciale rrit gjithashtu hapësirat për ndërhyrje nga komisionerët në caktimin e votave preferenciale.

Një tjetër aspekt i diskutueshëm ishte ndryshimi i mekanizmit të shkarkimit të kryesuesit dhe anëtarëve të KQZ-së. Përderisa më parë kjo kompetencë ishte ekskluzivisht në diskrecionin e Presidentit, tani shkarkimi mund të bëhet me propozim të shumicës prej 2/3 e anëtarëve të KQZ-së, nëse konstatohet shkelje e integritetit apo statusit të institucionit. Ky ndryshim rrezikon politizimin e vendimmarrjes brenda KQZ-së dhe mundëson cenimin e pavarësisë së institucionit në administrimin e procesit zgjedhor.

Kosova zbaton një kuotë të dyfishtë gjinore, e cila siguron që të paktën 30% e listave zgjedhore të jenë të përbëra nga gjinia më pak e përfaqësuar. I njëjti parim aplikohet edhe në ndarjen e ulëseve në Kuvend. Megjithatë, sfidat për rritjen e përfaqësimit të grave dhe garantimin e qasjes së barabartë në procesin zgjedhor mbeten të pranishme, pasi përfshirja e tyre në nivelet vendimmarrëse është ende e kufizuar.

Në përgjithësi, pavarësisht disa përmirësimeve teknike, ndryshimet ligjore nuk kanë adresuar sfidat thelbësore për transparencën dhe integritetin e zgjedhjeve, ndërsa disa amendamente kanë krijuar shqetësime për ndikimin e tyre afatgjatë në pavarësinë e institucioneve zgjedhore dhe integritetin e përfaqësimit politik.

### **Puna e trupave menaxhuese të zgjedhjeve**

---

Që nga shpallja e datës së zgjedhjeve, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ) ka zhvilluar rreth 35 mbledhje, duke miratuar vendime kyçe për organizimin e zgjedhjeve. Procesi vendimmarrës ka qenë përgjithësisht konsensual, megjithatë disa çështje të ndjeshme, si numri i qendrave të votimit për votimin jashtë vendit dhe certifikimi i subjekteve politike, kanë nxitur përplasje mes anëtarëve, kryesisht midis përfaqësuesve të partisë në pushtet dhe anëtarëve të tjerë.

Këto zgjedhje, si të parat zgjedhje të rregullta që nga shpallja e pavarësisë, janë zhvilluar sipas një kalendarit më të qëndrueshëm, duke i dhënë KQZ-së më shumë kohë për planifikim dhe ekzekutim. Megjithatë, pavarësisht këtij avantazhi, janë shënuar vonesa në disa procese kyçe, përfshirë miratimin e përbërjes së komisioneve komunale zgjedhore, krijimin e qendrave komunale të numërimit dhe publikimin e qendrave të votimit jashtë vendit. Vonesa e fundit u ndikua nga mungesa e koordinimit me Ministrinë e Punëve të Jashtme, e cila nuk ka ofruar me kohë të dhënat e nevojshme mbi përfaqësitë diplomatike të Kosovës.



Në nivel lokal, KQZ u përball me sfida të shumta për shkak të bojkotit dhe dorëheqjeve të përfaqësuesve serbë në komunat veriore. Për ta kompensuar këtë mungesë, KQZ caktoi përkohësisht zyrtarë nga komuna të tjera, një vendim që ndonëse operacionalisht i domosdoshëm, binte ndesh me legjislacionin në fuqi. Kjo situatë ngriti shqetësime mbi integritetin institucional dhe barazinë e qasjes në administratën zgjedhore për komunitetet e ndryshme.

Gjatë fushatës zgjedhore, KQZ miratoi një sërë vendimesh mbi numrin dhe shpërndarjen e qendrave të votimit dhe vendvotimeve. Në total, u emëruan mbi 15 mijë komisionerë për të menaxhuar procesin zgjedhor brenda vendit dhe mbi 150 për qendrat e votimit në përfaqësitë diplomatike jashtë Kosovës. Gjithashtu, u emëruan më shumë se 2,300 anëtarë në grupet e numërimit të votave në 38 Qendrat Komunale të Numërimit (QKN).

Megjithatë, procesi i emërimit të komisionerëve u shoqërua me sfida dhe paqartësi. Në disa komuna, partitë politike nominuan përfaqësues nga komunitete të tjera, duke krijuar tensione mbi ndarjen e vendeve në Këshillat e Vendvotimeve (KVV). Në disa raste, partitë e komuniteteve jo-shumicë shprehën pakënaqësi për përfaqësimin e tyre në komisionet komunale zgjedhore. Ankesat e tyre pranë Panelit Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP) u aprovuan, duke detyruar KQZ-në të rishikojë përbërjen e këtyre komisioneve. Ky zhvillim tregoi nevojën për një mekanizëm më transparent dhe gjithëpërfshirës për ndarjen e vendeve në administratën zgjedhore.

Trajnimi i komisionerëve filloi tetë ditë para zgjedhjeve, duke përfshirë për herë të parë një program të dedikuar për anëtarët e KVV-ve që do të menaxhonin votimin jashtë Kosovës. Ky hap përfaqëson një përmirësim në përgatitjen e stafit zgjedhor, megjithëse koha e kufizuar për trajnimet ngre shqetësime mbi efektivitetin e tyre.

Një zhvillim pozitiv në këto zgjedhje ishte përdorimi i teknologjisë për përmirësimin e procesit të raportimit dhe disa operacioneve zgjedhore. Me mbështetjen e OSBE-së, KQZ zbatoi sisteme të digjitalizuara për menaxhimin dhe përpunimin e të dhënave, gjë që kontribuoi në transparencën dhe efikasitetin e administrimit zgjedhor.

Një nga sfidat teknike kryesore të këtyre zgjedhjeve ishte çështja e ngjyrës matrikuluese. Procesi i tenderimit për këtë material u shoqërua me vonesa dhe probleme cilësore, duke çuar në kthimin e furnizimit vetëm një javë para zgjedhjeve. Pavarësisht se materialet u zëvendësuan, gjatë ditës së zgjedhjeve u raportuan raste ku matrikulimi i votuesve fshihej lehtësisht, duke ngritur shqetësime mbi efektivitetin e këtij mekanizmi. Për më tepër, vetë përdorimi i matrikulimit si metodë për shënimin e votuesve u kritikua nga organizatat e shoqërisë civile dhe Agjencia për Informim dhe Privatësi, të cilat e konsideruan atë si shkelje të fshehtësisë së votës.

Gjatë organizimit të zgjedhjeve, KQZ mori disa vendime që u kritikuan për cenimin e fshehtësisë së votës. Një prej tyre ishte vendosja e kabinave të votimit në pozita ballore, e cila u konsiderua problematike pasi rrezikonte ekspozimin e preferencave të votuesve. Ky vendim u ndryshua pas presionit nga shoqëria civile.

Për të rritur transparencën dhe parandalimin e manipulimeve, KQZ vendosi të shfrytëzojë kamera në vendvotime për regjistrimin e procesit zgjedhor. Ky vendim u prit me reagime të ndryshme, ku disa e vlerësuan si masë pozitive për rritjen e besimit publik, ndërsa të tjerë shprehën shqetësime mbi mbrojtjen e të dhënave personale dhe ndikimin e mundshëm në procesin e votimit.

Në përgjithësi, administrata zgjedhore ka arritur të zbatojë pjesën më të madhe të operacioneve brenda afateve të planifikuara, por me vonesa të konsiderueshme në disa procese kyçe. Përplasjet politike brenda KQZ-së, mungesa e koordinimit me institucionet e tjera dhe sfidat në përfaqësimin e drejtë të komuniteteve mbeten faktorë që kanë ndikuar në besueshmërinë dhe efikasitetin e këtij procesi.



## Certifikimi i subjekteve politike dhe kandidatëve

---

Procesi i certifikimit të subjekteve politike dhe kandidatëve për zgjedhjet parlamentare të 9 shkurtit 2025 u zhvillua brenda një periudhe 102-ditore, nga 1 shtatori deri më 11 dhjetor 2024. Gjatë kësaj periudhe, aplikuan për certifikim 28 subjekte politike me gjithsej 1,280 kandidatë. Në përgjithësi, KQZ miratoi aplikacionet e të gjitha subjekteve, me përjashtim të Listës Serbe, vendimi për të cilën shkaktoi debat të gjerë dhe ngriti shqetësime mbi qasjen e barabartë në garën zgjedhore.

Në rastin e Listës Serbe, KQZ mori një vendim të kundërligjshëm, duke refuzuar certifikimin e saj, pavarësisht rekomandimit të Zyrës për Regjistrimin e Partive Politike, e cila kishte konstatuar se subjekti i përmbushte kriteret ligjore. Ky vendim përbën ndikim politik mbi procesin administrativ zgjedhor, duke vënë në pikëpyetje pavarësinë e vendimmarrjes brenda KQZ-së. Më vonë, Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP) dhe Gjykata Supreme vendosën për certifikimin e këtij subjekti, duke e korrigjuar vendimin fillestar të KQZ-së. Ky rast tregoi jo vetëm sfidat e integritetit institucional brenda KQZ-së, por edhe dominimin e konsideratave politike mbi parimet ligjore në disa aspekte të administrimit të zgjedhjeve.

Në këto zgjedhje, morën pjesë 28 subjekte politike të ndara në 20 parti politike, 5 koalicione parazgjedhore, 2 iniciativa qytetare dhe 1 kandidat i pavarur. Nga numri i përgjithshëm i subjekteve, 8 ishin të spektrit politik shqiptar, 6 përfaqësonin komunitetin serb, 6 ishin nga komunitetet rom, ashkali dhe egjiptas, 4 boshnjake, 3 turke dhe 1 gorane. Nga partitë kryesore parlamentare, tri garuan individualisht – Lëvizja Vetëvendosje (LVV), Partia Demokratike e Kosovës (PDK) dhe Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), ndërsa Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës (AAK) hyri në një koalicion me parti të tjera më të vogla dhe iniciativa qytetare.

Një element me ndikim në procesin e certifikimit të kandidatëve ishte ndryshimi i kornizës ligjore në vitin 2023, i cili uli kriteret e përshtatshmërisë juridike për kandidatët. Kjo solli krijimin e listave zgjedhore që formalisht përmbushnin kërkesat ligjore, por në përbërjen e tyre përfshinin kandidatë që ende ishin nën ndjekje penale për vepra të ndryshme, përfshirë ato të ndërlidhura me korrupsionin. Kjo situatë rriti shqetësimet mbi ndikimin e mungesës së filtrave të përshtatshmërisë në integritetin e përfaqësimit politik dhe në perceptimin publik mbi besueshmërinë e kandidatëve.

## Lista e votuesve, Qendrat e Votimit dhe vendvotimet

---

Lista e votuesve për zgjedhjet parlamentare të 9 shkurtit 2025 është përpiluar nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ) bazuar në të dhënat e Regjistrimit Qendror Civil (RQC), të administruar nga Agjencia për Regjistrim Civil (ARC) në kuadër të Ministrisë së Punëve të Brendshme (MPB). Për këtë proces, KQZ ka marrë tre ekstrakte nga Departamenti i Gjendjes Civile (DGJC) dhe Departamenti për Prodhimin e Dokumenteve (DPD), duke verifikuar dhe përditësuar të dhënat mbi zgjedhësit e ligjshëm.

Lista përfundimtare përmban 2,075,868 votues, një numër ndjeshëm më i lartë se popullsia e regjistruar e Kosovës sipas regjistrimit të fundit të popullsisë. Rritja e këtij numri prej 174,888 votuesve krahasuar me zgjedhjet lokale të vitit 2021 përfshin 125,852 votues të rinj që kanë mbushur moshën 18 vjeç mes dy proceseve zgjedhore. Numri i votuesve të regjistruar brenda Kosovës është 1,970,944, ndërsa 104,924 votues janë përfshirë në listën për votim nga jashtë vendit.

Numri i qendrave të votimit në Kosovë për këto zgjedhje ishte 903, me gjithsej 2,533 vendvotime të rregullta. Gjithashtu, KQZ ka miratuar funksionimin e 38 qendrave të votimit me kusht, me 56 vendvotime shtesë për rastet e veçanta.

Gjatë procesit të pastrimit dhe verifikimit të listës së votuesve, KQZ ka kërkuar të dhëna nga Këshilli Gjyqësor i Kosovës (KGJK), Departamenti i Pensioneve (DP) dhe Agjencia e Statistikave të Kosovës (ASK) për të eliminuar personat që nuk kualifikoheshin për të votuar. Nga lista janë larguar 160 persona për



shkak të humbjes së zotësisë për veprim, si dhe 915 votues të tjerë të konfirmuar të vdekur bazuar në të dhënat e institucioneve përkatëse. Për më tepër, KQZ vendosi të përjashtojë nga lista votuesit mbi 100 vjeç që nuk figuronin në regjistrat aktivë të dokumentacionit civil.

Në kuadër të procesit të përditësimit të listës, KQZ ofroi periudhën e Shërbimit të Votuesve nga 29 gushti deri më 26 dhjetor 2024, ku qytetarët mund të verifikonin qendrën e tyre të votimit dhe të kërkonin ndërrimin e saj. Gjatë kësaj periudhe u pranuan 17,219 kërkesa për ndërrim, nga të cilat 16,503 u aprovuan dhe 716 u refuzuan.

Megjithëse KQZ ka përmbushur detyrimet e saj ligjore për përditësimin e listës së votuesve, sfida e numrit të lartë të votuesve të regjistruar në raport me popullsinë e vërtetë mbetet një çështje serioze, e cila cenon besimin e publikut në zgjedhje.

### Procesi i votimit jashtë vendit

---

Për shkak të ndryshimeve ligjore dhe natyrës komplekse të procesit, votimi jashtë Kosovës ishte një nga çështjet më të diskutuara në këto zgjedhje. Periudha e aplikimit për regjistrim si votues jashtë vendit zgjati 142 ditë, nga 23 gushti 2024 deri më 11 janar 2025.

Pas përfundimit të regjistrimit dhe trajtimit të kundërshtimeve dhe ankesave nga PZAP, lista e votuesve jashtë Kosovës përmbante 104,924 persona. Në përputhje me nenin 96, paragrafi 9 të Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme, këta votues u larguan nga lista e votuesve brenda Kosovës për të shmangur votimin e dyfishtë. Sa i përket mënyrës së votimit, 67,421 votues u regjistruan për të dërguar votën me postë në kutinë postare jashtë Kosovës, 20,399 u regjistruan për të votuar fizikisht në përfaqësitë diplomatike, ndërsa 17,104 për të dërguar votën përmes postës në Kosovë.

Aplikacionet për votim jashtë vendit u pranuan nga 75 shtete, ku Gjermania dhe Zvicra përbënin mbi 70% të aplikimeve, me 44,774 dhe 27,248 aplikime, përkatësisht. Kjo konfirmon dominimin e diasporës kosovare në këto dy vende si një faktor elektoral gjithnjë e më i rëndësishëm.

Numri i përgjithshëm i zarfeve me fletëvotime të pranuar nga kutitë postare jashtë Kosovës dhe të konfirmuara nga shërbimi postar deri më 7 shkurt ishte 50,226, ndërsa në Kosovë arritën 40,859 prej tyre. Pavarësisht se votimi përmes postës u zgjodh si opsioni kryesor, procesi u shoqërua me debate dhe dyshime mbi integritetin e tij.

Një nga çështjet më të diskutuara ishte përfshirja e Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Diasporës (MPJD) në procesin e transportimit të votave nga kutitë postare jashtë vendit. Pas dështimit të KQZ-së për të angazhuar një operator privat për këtë proces, me vendim të datës 21 janar 2025, u autorizua ushtruesi i detyrës së Drejtorit të Sekretariatit të KQZ-së për të krijuar një ekip transporti. Ky ekip përbëhej nga 9 persona të KQZ-së dhe 7 nga MPJD-ja, të cilët u ngarkuan me tërheqjen dhe sjelljen e zarfeve me vota në Kosovë.

Megjithëse ky vendim ishte proceduralisht në përputhje me legjislacionin në fuqi, ai ngjalli shqetësime mbi ruajtjen e paanshmërisë së procesit, duke ngritur pyetje mbi ndikimin e mundshëm të MPJD-së, një institucion nën kontrollin e qeverisë. Ky fakt u kritikua nga organizatat e shoqërisë civile dhe disa subjekte politike, të cilat pretenduan se mund të kishte ndërhyrje të mundshme në votat e diasporës. Mediat dhe vëzhguesit zgjedhorë raportuan gjithashtu mbi pasigurinë e këtij procesi, duke sugjeruar nevojën për standardizim më të mirë të mekanizmave të mbikëqyrjes në zgjedhjet e ardhshme.

Në përgjithësi, votimi jashtë Kosovës tregoi një interes të lartë të diasporës për të marrë pjesë në procesin demokratik, por mbeti një nga segmentet më të ndjeshme të zgjedhjeve, me sfida në logjistikë, siguri dhe mbikëqyrje institucionale.



## Fushata zgjedhore

---

Fushata zgjedhore për zgjedhjet parlamentare të 9 shkurtit 2025 ishte e para me një kohëzgjatje të plotë prej 30 ditësh, duke sjellë një ritëm më të lartë të aktiviteteve dhe një angazhim të shtuar të subjekteve politike në terren dhe në hapësirat digjitale.

Gjatë kësaj periudhe, përmes mbi 40 vëzhguesve afatgjatë, Demokracia në Veprim (DnV) monitoroi një fushatë që, pavarësisht se u zhvillua në një mjedis përgjithësisht të qetë, ishte tejet e ashpër në aspektin e diskursit politik. Monitorimi i DnV-së evidentoi rreth 800 aktivitete publike të organizuara nga partitë politike në të gjitha komunat e Kosovës, përfshirë komunat me shumicë serbe, ku për herë të parë garuan gjashtë parti serbe, duke shënuar një diversifikim më të madh të konkurrencës brenda këtij komuniteti.

Një nga elementet më të theksuara të kësaj fushate ishte përshkallëzimi i retorikës dhe përdorimi i një gjuhe të ashpër nga subjektet politike dhe kandidatët e tyre. Shpeshherë, fushata u karakterizua nga sulme të ndërsjella, akuza personale dhe përdorimi i termave denigrues, duke krijuar një atmosferë të polarizuar që minon standardet e një gare të drejtë dhe demokratike. Kjo tendencë ishte e dukshme si në tubimet elektorale, ashtu edhe në hapësirat digjitale, ku u vërejt një rritje e ndjeshme e rasteve të gjuhës së urrejtjes dhe fyerjeve. Kjo situatë reflektoi edhe në numrin e madh të vendimeve dënuese të Panelit Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), i cili shqiptoi gjopa të shumta për shkelje të rregullave të fushatës, kryesisht për përdorimin e gjuhës nxitëse dhe shkeljeve të tjera të kodit të mirësjelljes zgjedhore. Për herë të parë, PZAP-ja filloi shqiptimin e ndëshkimeve edhe për shkeljet e supozuara nga mbështetësit e subjekteve politike, për shkak të gjuhës së përdorur nga ana e tyre, qoftë në tubime në terren apo në rrjete sociale. Gjithashtu, fenomeni i dezinformimit dhe përhapjes së mesazheve manipulative ishte i pranishëm, sidomos në rrjetet sociale dhe platformat digjitale, duke ndikuar në perceptimin e publikut mbi kandidatët dhe platformat politike.

Përtej ashpërsimit të retorikës dhe intensitetit të fushatës, disa incidente kanë shënuar këtë periudhë, duke ngritur shqetësime mbi respektimin e standardeve demokratike. Rastet kryesore të incidenteve përfshijnë hedhjen e mjeteve të forta dhe atyre piroteknike në një tubim në Skenderaj, djegien e materialeve propaganduese të kandidatëve, si dhe disa incidente në komunat me shumicë serbe, të tilla si pengimi i aktiviteteve elektorale në Graçanicë, hedhja e një kokteji molotovi mbi një veturë të KQZ-së dhe disa incidente të tjera në veri të vendit. Këto raste jo vetëm që kanë rritur tensionet në terren, por gjithashtu kanë ndikuar në perceptimin mbi lirinë e grumbullimit gjatë fushatës.

Nga ana tjetër, një aspekt pozitiv i kësaj fushate ishte vëmendja më e madhe e subjekteve politike ndaj çështjeve programore, duke reflektuar një përpjekje më të strukturuar për të adresuar temat me interes për qytetarët. Përkundër rasteve të gjuhës së urrejtjes dhe diskursit polarizues, debatet politike në tërësi shfaqën një nivel më të lartë të diskutimit mbi çështje konkrete si arsimi, ekonomia, mirëqenia sociale, siguria dhe mbrojtja. Një tipar dallues i kësaj fushate ishte diferencimi i qartë i prioriteteve mes partisë në pushtet dhe partive opozitare. Derisa partia në pushtet e orientoi narrativën e saj kryesisht rreth çështjeve të sovranitetit dhe integritetit territorial, me fokus të veçantë në veriun e vendit, partitë opozitare u përqendruan më shumë në problematikat ekonomike dhe arsimin, duke ofruar alternativa për zhvillimin dhe rimëkëmbjen e vendit. Ky diversitet në prioritetet politike pasqyroi qasjet e ndryshme të subjekteve në raport me sfidat e vendit, megjithatë, shpeshherë mungoi një analizë më e thelluar dhe konkrete mbi zbatueshmërinë e propozimeve të tyre.

Gjatë fushatës zgjedhore, peizazhi mediatik ishte i polarizuar, duke u karakterizuar nga dy zhvillime kryesore: partia në pushtet mbajti një qasje vazhdimisht konfrontuese ndaj gazetarëve, ndërsa disa media u perceptuan si të njëanshme në mbulimin dhe raportimet e tyre. Kryeministri dhe zyrtarët e partisë në pushtet përdorën një retorikë sulmuese ndaj mediave, duke i akuzuar për manipulim dhe ndikim negativ në opinionin publik. Në disa raste, ekipe të gazetarëve u penguan të raportonin nga terreni, ndërsa bojkoti i disa medimeve nga Lëvizja Vetëvendosje kufizoi ndjeshëm transparencën dhe





krijoi pabarazi në aksesin e qytetarëve në informacion të balancuar mbi ofertat elektorale, duke ndikuar në cilësinë e debatit publik.

Fushata e këtij viti ka sjellë gjithashtu një mobilizim të madh në rrjetet sociale, me një rritje të konsiderueshme të numrit të postimeve të sponsorizuara dhe shpenzimeve për promovim digjital nga ana e partive dhe kandidatëve. Pavarësisht rritjes së intensitetit të fushatës online, transparenca mbi financimin e këtyre aktiviteteve mbetet çështje e hapur, me monitorimin që ka evidentuar vështirësi në identifikimin e burimeve të financimit dhe kontrollin e shpenzimeve nga organet përkatëse.

Një tjetër çështje me rëndësi gjatë kësaj fushate ishte përfshirja e grave dhe grupeve të marginalizuara në proces. Pjesëmarrja e grave në aktivitetet e fushatës mbeti e ulët, si në aspektin e hapësirës së ofruar për gratë candidate, qoftë si folëse në tubime apo debate televizive. Për më tepër, gratë candidate u përballën me një numër të lartë sulmesh të drejtpërdrejta në hapësirat online, një prirje që tregon sfidat e vazhdueshme në sigurimin e një mjedisi të barabartë për të gjithë pjesëmarrësit në procesin zgjedhor.

Në përgjithësi, fushata zgjedhore e vitit 2025 është zhvilluar pa incidente madhore që do të kishin ndikuar në ecurinë e përgjithshme të procesit, por ka ngritur shqetësime serioze mbi cilësinë e debatit politik dhe respektimin e etikës zgjedhore.

### **Parafushata**

Mungesa e rregullimit ligjor për parafushatën zgjedhore ka krijuar një hapësirë të pakufizuar për aktivitetet e hershme elektorale të partive politike në Kosovë. Ky vakum u ka mundësuar subjekteve politike një fleksibilitet të madh në përcaktimin e strategjive dhe kanaleve të komunikimit me votuesit, duke e bërë praktikisht të pamundur dallimin midis aktivitetit politik të zakonshëm dhe atij zgjedhor. Si pasojë, partitë kanë ndërtuar taktika të ndryshme për të përfituar nga kjo situatë, qoftë përmes aktiviteteve në terren, takimeve me strukturat e tyre apo fushatave digjitale.

Një nga prirjet më të spikatura gjatë kësaj periudhe ka qenë dominimi i eksponentëve politikë në debatet televizive, sidomos nga spektri opozitar, të cilët kanë përdorur hapësirat mediatike për të përforcuar narrativat e tyre dhe për të sfiduar qeverinë në detyrë. Kjo ka krijuar një dinamikë të re në komunikimin elektorale, duke ofruar një platformë për polarizim të mëtejshëm politik.

Sa i përket strategjive të ndjekura nga partitë, Lëvizja Vetëvendosje e ka orientuar parafushatën e saj kryesisht jashtë Kosovës, duke u mbështetur te diaspora si një burim i rëndësishëm mbështetjeje elektorale. Përmes takimeve të shpeshta me mërgatën në disa shtete evropiane, partia në pushtet ka synuar të ruajë dhe forcojë bazën e saj elektorale, duke shmangur organizimin e takimeve të mëdha publike brenda vendit në këtë fazë të hershme. Kjo qasje tregon një strategji të menduar për të ruajtur momentumin politik dhe për të shmangur ekspozimin e drejtpërdrejtë ndaj kritikave në terren.

Në anën tjetër, partitë opozitare kanë zhvilluar qasje të ndryshme për të mobilizuar votuesit dhe për të ndërtuar diskursin e tyre politik. Partia Demokratike e Kosovës (PDK) ka adoptuar një model të hapur konsultativ për hartimin e programit të saj politik, duke organizuar punëtorë në të gjithë vendin me qëllim përfshirjen e publikut në procesin e formulimit të platformës zgjedhore. Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), ndërkohë, ka përdorur një strategji më tradicionale të angazhimit qytetar përmes takimeve të drejtpërdrejta dhe fushatës derë më derë, duke u përpjekur të krijojë lidhje më të afërta me elektoratin. Një model i ngjashëm është ndjekur edhe nga koalicioni AAK-NISMA, me fokus të veçantë në përforcimin e mesazhit politik për një qeverisje më gjithëpërfshirëse dhe pragmatike.

Ndërkohë, edhe pse komunikimi politik gjatë kësaj periudhe ka qenë përgjithësisht i moderuar, janë vërejtur momente të polarizimit të thellë mes pozitës dhe opozitës. Retorika e ashpër ka qenë e pranishme, veçanërisht në rastet kur partitë opozitare kanë shfrytëzuar këtë fazë për të denoncuar dështimet e qeverisë, duke theksuar sfidat e ekzekutivit në raport me aleatët ndërkombëtarë, krizën



institucionale dhe mangësitë në sektorët kyç të qeverisjes. Nga ana tjetër, Vetëvendosje ka ndjekur një qasje të qëndrueshme, duke u mbështetur te narrativa e saj për "pastrimin" e skenës politike nga korrupsioni dhe për nevojën e vazhdimin të reformave. Ky përplasje mes dy vizioneve të kundërta politike ka krijuar një ndarje të thelluar në diskursin publik, duke e bërë më të vështirë zhvillimin e një debati të bazuar në propozime të argumentuara dhe të matshme.

Një element tjetër i rëndësishëm i kësaj periudhe ka qenë ndërhyrja e qeverisë përmes masave financiare me ndikim social, të cilat kanë ngritur shqetësime mbi mundësinë e përdorimit të resurseve publike për qëllime elektorale. Vendime të tilla si rritja e pensioneve për kategori të ndryshme, rritja e pagës minimale dhe shpërndarja e ndihmave financiare për segmente të ndryshme të popullsisë, ndonëse në dukje janë masa sociale të drejta, kanë ngjallur debat mbi ndikimin e tyre në zgjedhje dhe mbi motivet politike që mund të fshihen pas tyre.

Më e diskutueshmja ndër këto masa mbetet vendimi i qeverisë për të shpërndarë nga 100 euro për rreth 700,000 qytetarë si ndihmë për festat e fundvitit, një veprim që është interpretuar nga aktorët politikë si një tentativë për të ndikuar tek elektorati në prag të zgjedhjeve. Po ashtu, përfshirja e Kryeministrit Kurti në ceremoninë e ndarjes së "kartelave të punës" për të punësuarit e rinj në KEK, dhe promovimi i projekteve qeveritare gjatë kësaj periudhe, kanë krijuar perceptimin e një fushate të mbështetur mbi burimet shtetërore, një praktikë që bie në kundërshtim me standardet ndërkombëtare për barazinë e garës zgjedhore.

Në nivel lokal, janë vërejtur raste të shfrytëzimit të projekteve komunale për promovim elektoral, duke përfshirë prerjen e shiritave dhe inaugurimin e investimeve publike në prag të zgjedhjeve, një taktikë e përdorur më parë edhe nga qeverisjet e mëparshme. Këto praktika ngjallin shqetësime mbi integritetin e garës zgjedhore dhe mundësinë e ndikimit indirekt të qeverisë tek zgjedhësit përmes përfitimeve financiare dhe ekonomike.

Në përgjithësi, parafushata zgjedhore në Kosovë ka vijuar të mbetet një periudhë e pakontrolluar dhe e pandarë qartë nga fushata zyrtare, duke krijuar një terren të pabarabartë për konkurrencën mes partive politike. Përdorimi i burimeve shtetërore për përfitime elektorale, mungesa e rregullimit ligjor të kësaj periudhe dhe polarizimi i diskursit politik mbeten çështje thelbësore që duhen adresuar për të siguruar një proces zgjedhor më të drejtë dhe më transparent.

### **Shpenzimet e subjekteve politike gjatë fushatës**

---

Gjatë fushatës zgjedhore 30-ditore, Demokracia në Veprim (DnV) ka monitoruar dhe analizuar shpenzimet e subjekteve politike dhe kandidatëve të tyre në rrjetet sociale. Të dhënat e mbledhura tregojnë një rritje të ndjeshme të numrit të postimeve të sponsorizuara dhe të shumës totale të shpenzuar, duke reflektuar një përqendrim të theksuar të strategjive të fushatës në hapësirën digjitale.

Në total, janë identifikuar rreth 8,000 postime të sponsorizuara nga subjektet politike dhe kandidatët e tyre, me një shumë të përgjithshme të shpenzimeve që kap vlerën mbi 200,000 euro. Kjo rritje e ndjeshme e investimeve në fushata digjitale tregon se rrjetet sociale po shndërrohen në mjetin primar të komunikimit elektoral, duke zëvendësuar në një masë të madhe format tradicionale të promovimit.

Analiza e të dhënave tregon se gjatë javës së fundit të fushatës ka pasur një intensifikim masiv të sponsorizimeve, që sugjeron përpjekje të partive dhe kandidatëve për të përforcuar mesazhet e tyre elektorale në momentet e fundit të garës.

Në listën e kandidatëve me shpenzimet më të larta për sponsorizime në Facebook dhe Instagram kryeson kandidati i LDK-së për Kryeministër, Lumir Abdixhiku, me mbi 18,000 euro të shpenzuara për 153 postime të sponsorizuara. Pas tij renditet kandidati i PDK-së, Bedri Hamza, me mbi 17,000 euro, të shpërndara në rreth 300 postime. Interesante është se në vendin e tretë për shpenzime renditet një subjekt nga



komuniteti rom, Opre Roma Kosova, me një total prej 16,000 euro të shpenzuara. Lëvizja Vetëvendosje, si partia në pushtet, ka sponsorizuar numrin më të madh të postimeve – rreth 900 – por me një vlerë relativisht më të ulët, 14,000 euro.

Profilet e Memli Krasniqit – me 10 mijë euro; Ramush Haradinajt – me gati 9 mijë euro; profili zyrtar i LDK-së me rreth 8 mijë euro; kandidatit të LDK-së, Krenar Xhaferi – me 5,600 euro; kandidatit të AAK-së, Egzon Kelmendi – me rreth 4 mijë euro; si dhe kandidates së PDK-së, Aurora Berisha – me 3,400 euro; përmbyllin listën e top dhjetë shpenzuesve më të mëdhenj në rrjete sociale për 30 ditët e kaluara.

Pavarësisht shpenzimeve të larta, transparencja mbi financimin e këtyre aktiviteteve mbetet e diskutueshme. Monitorimi i DnV ka evidentuar sfida në ndjekjen e burimeve të financimit dhe kontrollin e shpenzimeve nga institucionet përkatëse, gjë që ngritë pikëpyetje mbi mundësinë e financimeve të padeklaruara apo përdorimit të fondeve nga burime të pidentifikuara.

### Monitorimi i mediave gjatë fushatës

---

Monitorimi i mbulimit mediatic të fushatës zgjedhore për zgjedhjet parlamentare të 9 shkurtit 2025 tregon një dominim të subjekteve të mëdha politike, ndërsa subjektet më të vogla kanë pasur më pak hapësirë në televizione dhe media digjitale. Në debatet zgjedhore të mbajtura nga 11 janari deri më 8 shkurt, televizionet kryesore RTK, KTV, Klan Kosova, RTV 21, TV Dukagjini, T7, Kanal 10, Tëvë1 dhe RTV Puls kanë mbajtur gjithsej 417 debate. Nga këto, shumica ishin me një kandidat ose analistë, ndërsa vetëm në 108 raste u prezantuan programet e partive.

Pjesëmarrja e partive në këto debate ka pasur dallime të mëdha. Partia Demokratike e Kosovës ka marrë pjesë në 103 debate, Koalicioni AAK-NISMA-Konservatorët në 98, Lidhja Demokratike e Kosovës në 77 dhe Lëvizja Vetëvendosje në vetëm 38. Gjithashtu, përfaqësimi i grave ka mbetur i ulët, me vetëm 21% të kandidatëve pjesëmarrës në debate që ishin gra.

Për sa i përket kronikave zgjedhore, janë transmetuar gjithsej 1,887 kronika, ku katër partitë kryesore – LDK, PDK, AAK-NISMA dhe LVV – kanë zënë shumicën dërrmuese të hapësirës televizive, me gjithsej 2959 minuta. Liderët e partive kanë pasur qasje të pabarabartë në media, me Lumir Abdixhikun që dominoi me 300 minuta ekspozim televiziv, i ndjekur nga Bedri Hamza me 286, Albin Kurti me 237 dhe Ramush Haradinaj me 179 minuta. Kandidatët burra kanë qenë të pranishëm në 86% të kronikave, ndërsa gratë vetëm në 14%, duke treguar një mungesë të theksuar të barazisë gjinore.

Edhe në mediat online është vërejtur një qasje e ngjashme. Nga monitorimi i 13 portaleve, janë identifikuar 429 transmetime live nga fushata, ku Koalicioni AAK-NISMA kishte dominimin më të madh me 12,353 minuta transmetim, i ndjekur nga LDK me 3,322 dhe PDK me 2,264 minuta. Një numër i madh i këtyre transmetimeve nuk ka përmbajtur informacion për sponsorizimin, duke ngritur shqetësime për transparencën e financimit.

Komisioni i Pavarur i Mediave ka qenë jofunksional gjatë kësaj fushate për shkak të mosplotësimit të anëtarëve nga Kuvendi i Kosovës. Kjo ka ndikuar në transparencën dhe efektivitetin e rregullimit të hapësirës mediatike. Gjatë kësaj periudhe, KPM ka pranuar 28 ankesa, shumica e të cilave kishin të bënin me shpifje, nxitje të urrejtjes dhe shkelje të Kodit të Etikës nga televizione të ndryshme.

### Vëzhguesit e zgjedhjeve

---

Zgjedhjet parlamentare të 9 shkurtit 2025 u monitoruan nga një numër i konsiderueshëm vëzhguesish, duke përfshirë përfaqësues të partive politike, organizatave të shoqërisë civile, misioneve ndërkombëtare dhe mediave. Në total, mbi 20,000 vëzhgues u akredituan për të mbikëqyrur



mbarëvajtjen e procesit zgjedhor në të gjitha nivelet. Pjesëmarrja e gjerë e vëzhguesve dëshmon për interesin e lartë për transparencën e procesit zgjedhor.

Partitë politike mbetën aktorët kryesorë në procesin e vëzhgimit, duke akredituar në total 18,432 vëzhgues.<sup>1</sup> Lëvizja Vetëvendosje udhëhoqi listën me 4,356 vëzhgues, e ndjekur nga PDK me 4,034, LDK me 3,962, dhe koalicioni AAK-NISMA me 3,571. Lista Serbe, e cila fillimisht u përball me vështirësi në certifikimin e saj, angazhoi 290 vëzhgues. Ky angazhim masiv i vëzhguesve partiakë reflekton konkurrencën e lartë ndërmjet partive dhe përpjekjet për të mbrojtur votat e tyre.

Përveç aktorëve vendorë, zgjedhjet u monitoruan edhe nga institucione ndërkombëtare. Misioni i Bashkimit Evropian për Vëzhgimin e Zgjedhjeve (EU-EOM) kishte 163 vëzhgues, duke qenë organizata ndërkombëtare me praninë më të madhe. Gjithashtu, institucione të tjera si Asambleja Parlamentare e Këshillit të Evropës (54 vëzhgues), NDI (35 vëzhgues), OSBE dhe përfaqësi të ndryshme diplomatike si Ambasada Amerikane (24 vëzhgues), Britanike (30 vëzhgues) dhe ajo e BE-së (19 vëzhgues) kontribuan në vëzhgimin e procesit.

Organizatat e shoqërisë civile gjithashtu luajtën një rol kyç në monitorimin e zgjedhjeve, duke angazhuar mbi 1,126 vëzhgues nga 21 organizata të ndryshme.<sup>2</sup> Demokracia në Veprim (DnV) ishte rrjeti më i madh i vëzhgimit të shoqërisë civile, me 730 vëzhgues të shpërndarë në të gjithë Kosovën.

### **Përfshirja e grave në proces zgjedhor**

Përfaqësimi i grave në zgjedhjet parlamentare të 9 shkurtit 2025 vazhdoi të jetë i kufizuar, duke reflektuar një mungesë të barazisë gjinore në procesin zgjedhor. Përkundër kërkesave ligjore që përcaktojnë një kuotë minimale prej 30% për përfshirjen e grave në listat zgjedhore, shumica e partive politike nuk kanë shkuar përtej këtij minimumi ligjor, duke mos krijuar hapësira më të mëdha për gratë në struktura drejtuese apo në listat zgjedhore. Nga 1,280 kandidatët e certifikuar, vetëm 412, apo 32%, ishin gra, duke dëshmuar se gratë ende nuk kanë qasje të barabartë në vendimmarrje politike.

Në prag të zgjedhjeve, Gjykata Kushtetuese vendosi se neni 28 i Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme është në përputhje me Kushtetutën, duke vërtetuar se kuotat gjinore prej 30% janë të ligjshme dhe nuk bien në kundërshtim me të drejtat zgjedhore. Megjithatë, përfaqësimi më i lartë i synuar nga Ligji për Barazi Gjinore prej 50% mbeti një aspiratë dhe jo një detyrim konkret për partitë. Në këto zgjedhje, përqindja e grave në listat e partive kryesore tregoi pak ndryshim nga zgjedhjet e kaluara. Lëvizja Vetëvendosje kishte 37% gra në listën e saj, ndërsa Partia Demokratike e Kosovës dhe Lidhja Demokratike e Kosovës kishin

<sup>1</sup> 1. Lëvizja VETËVENDOSJE! angazhoi 4,356 vëzhgues; 2. Partia Demokratike e Kosovës –4034 vëzhgues 3. Lidhja Demokratike e Kosovës , 3,962 vëzhgues; 4. Kosova Demokratik Türk Partisi, 257 vëzhgues; 5. Socjaldemokratska Unija – SDU, 102 vëzhgues; 6. Iniciativa e Re Demokratike e Kosovës – IRDK, 158 vëzhgues; 7. Srpska Lista, 290 vëzhgues; 8. AAK - Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës NISMA - Nisma Socialdemokrate, Konservatorët, Intelektualët, 3,571 vëzhgues; 9. Opre Roma Kosova, 21 vëzhgues; 10. Koalicija Vakati, 700 vëzhgues; 11. Srpski narodni pokret, 88 vëzhgues; 12. Za Slobodu Pravdu i Opstanak, 96 vëzhgues; 13. Yenilikçi Türk Hareket Partisi, 51 vëzhgues; 14. Koalicioni për Familje, 253 vëzhgues; 15. Gradjanska Inicijativa Narodna Pravda, 26 vëzhgues; 16. PDAK-LPB, 74 vëzhgues; 17. Naša Bošnjačka Koalicija (Naša Inicijativa i Bošnjačka stranka, 28; 18. Partija kosovskih Srba, 11 vëzhgues; 19. Nova Demokratska Stranka, 260 vëzhgues; 20. Partia Liberale Egjiptiane – PLE, 36 vëzhgues; 21. Jedinstvena Goranska Partija, 58 vëzhgues.

<sup>2</sup> 1. Instituti Demokratik i Kosovës (KDI), me 306 vëzhgues; 2. Lëvizja FOL, më 6 vëzhgues; 3. Rrjeti Ballkanik i Gazetarisë Hulumtuese (BIRN), me 48 vëzhgues; 4. Rjeti i OJQ-ve AVONET, me 4 vëzhgues; 5. Qendra për Politika dhe Avokim (QPA), me 140 vëzhgues; 6. Democracy Plus, me 11 vëzhgues; 7. Qendra Kulturore Orfeu, me 154 vëzhgues; 8. Germin, 16 vëzhgues; 9. Demokracia për Zhvillim (D4D), me 9 vëzhgues; 10. Syri i Vizionit, me 124 vëzhgues; 11. Rinia për Zhvillim dhe Bashkëpunim, me 14 vëzhgues; 12. INTERNWËS KOSOVA, me 21 vëzhgues; 13. PIPOS, me 81 vëzhgues; 14. Youth Association for Human Rights, me 2 vëzhgues; 15. Kosovo Center for International Cooperation, me 56 vëzhgues; 16. Udruženje Gradjana RESTART, me 24 vëzhgues; 17. Primo la Tolleranza, me 17 vëzhgues; 18. Centre For Social Inclusion Gracanica, me 27 vëzhgues; 19. Center for Cooperation and Networking of Organizations, me 13 vëzhgues; 20. Centar za Mir i Toleranciju Pristina, me 36 vëzhgues; 21. ADVOCACY CENTER FOR DEMOCRATIC CULTURE, me 17 vëzhgues.



secila nga 34%. Koalicioni AAK-Nisma përfshiu 32% gra në listën e tij, duke treguar një qasje minimale përtej detyrimit ligjor.

Përtej përfaqësimit numerik në lista, gratë vazhduan të përballen me barriera të mëdha gjatë fushatës. Pjesëmarrja e tyre në tubimet elektorale dhe në promovimin e ideve politike ishte e kufizuar, duke reflektuar një mjedis ku gratë nuk gëzojnë qasje të barabartë për të komunikuar me votuesit. Vetëm 44 gra ishin folëse në tubimet publike të partive, nga më shumë se 160 folës gjithsej. Në shumicën e rasteve, pjesëmarrja e grave në aktivitete zgjedhore mbeti simbolike, me më pak se 10% të pjesëmarrësve në shumë prej këtyre ngjarjeve.

Në hapësirat mediatike, situata ishte po aq problematike. Në 376 debate televizive të monitoruara, vetëm 22% e pjesëmarrësve ishin gra. Edhe në kronikat zgjedhore, përfaqësimi ishte tejet i ulët, me vetëm 14% të kronikave që përfshinin kandidatë gra. Koha e ofruar për gratë në mediat audiovizive ishte gjithashtu e pabarabartë, me vetëm 46 minuta hapësirë televizive për kandidatet, që përbënte rreth 12% të kohës së përgjithshme të mbuluar për të gjithë kandidatët.

Mungesa e mbështetjes së subjekteve politike për gratë në fushatë ndikoi drejtpërdrejt në mundësitë e tyre për të konkurruar në mënyrë të barabartë. Kandidatet gra nuk patën mundësi të njëjta për të promovuar platformat e tyre politike dhe për të komunikuar drejtpërdrejt me elektoratin, duke krijuar një fushatë zgjedhore ku gratë u përballën me disavantazhe të mëdha krahasuar me kandidatët burra. Kjo situatë vazhdon të dëshmojë se barazia gjinore në politikë nuk mund të arrihet vetëm përmes kuotave ligjore, por kërkon një angazhim më të thellë nga subjektet politike për të garantuar përfshirjen dhe fuqizimin real të grave në proceset zgjedhore.

### **Dita e Zgjedhjeve – Votimi dhe numërimi**

---

Demokracia në Veprim ka vëzhguar mbarëvajtjen e procesit në Ditën e Zgjedhjeve përmes 500 vëzhguesve afatshkurtër të shpërndarë në 500 vendvotime sipas një mostre përfaqësuese. Raportimi për ecurinë e procesit dhe numërimin e rezultateve preliminare për subjektet politike është bërë sipas metodologjisë së Numërimit Paralel të Votave (PVT).

Dita e zgjedhjeve, që nga hapja e vendvotimeve në orën 07:00, ka rrjedhur në një atmosferë të qetë dhe demokratike, e karakterizuar nga një interesim i lartë i votuesve për të marrë pjesë në zgjedhje. Megjithatë, procesi i votimit është shoqëruar me disa parregullsi dhe shkelje, kryesisht të natyrës procedurale. Nuk është raportuar për incidente serioze që do të mund të cenonin integritetin e zgjedhjeve.

Me përjashtim të 9% të vendvotimeve që janë hapur me vonesa të vogla, votimi ka filluar me kohë në të gjithë vendin. Është raportuar se arsyeja kryesore e vonesave ka qenë mungesa e komisionerëve në 6% të vendvotimeve. Ndryshe nga zgjedhjet e kaluara, KQZ, një ditë para zgjedhjeve, mori vendim për të lejuar votimin edhe me dokumente të skaduar të lëshuara nga Republika e Kosovës. Megjithatë, në 12% të vendvotimeve është raportuar për raste të izoluar të lejimit të votimit me dokumente jo valide.

Problematikat kryesore që kanë karakterizuar procesin e votimit lidhen me vështirësitë e votuesve për të gjetur vendvotimin e saktë, rastet e shumta të votimit me asistencë dhe përvojat e ndryshme të qytetarëve lidhur me cilësinë e ngjyrës matrikuluese, e cila është aplikuar për herë të parë për shënjinimin e votuesve. Për më tepër, 20% e Qendrave të Votimit kanë qenë të papërshtatshme për persona me aftësi të kufizuara fizike.



Vështirësi me lokalizimin e vendvotimit nga votuesit janë raportuar në 52% të vendvotimeve, dhe në disa raste numri i tyre ka arritur deri në 100 votues për një vendvotim. Demokracia në Veprim ka vlerësuar se ky fenomen lidhet me ndryshimet e Qendrave të Votimit në gjithë Kosovën, të cilat janë bërë për t'u mundësuar votuesve të votojnë më afër vendbanimit të tyre. KQZ kishte mundësuar verifikimin elektronik të vendvotimit paraprakisht, por kjo nuk ka qenë e mjaftueshme për të shmangur konfuzionin.

Përkundër shtrëngimit të rregullave për votimin me asistencë, ky fenomen ka qenë mjaft i përhapur. Nga totali i qytetarëve që kanë votuar, 6% e tyre kanë votuar me asistencë, ndërsa më shumë se dy të tretat ishin gra. Këto raste janë evidentuar në Librin e Votimit, por në 9% të vendvotimeve ka pasur raste të mosevidentimit. Gjithashtu, në 6% të vendvotimeve janë raportuar raste të fotografimit të fletëvotimeve, edhe pse në numër të vogël.

### **Numërimi**

Vëzhguesit e Demokracisë në Veprim kanë monitoruar edhe procesin e numërimit në 500 vendvotime, pas mbylljes me kohë të 93% të tyre. Është raportuar se 7% e vendvotimeve janë mbyllur para orës 19:00, ndërsa në 13% të vendvotimeve votuesit që ishin në radhë janë lejuar të votojnë. Pas tabulimit dhe verifikimit të rezultateve me metodën e PVT-së, Demokracia në Veprim ka publikuar rezultatet preliminare për subjektet kryesore politike në orën 22:00.

Publikimi i rezultateve preliminare ka kontribuar në transparencën e procesit dhe informimin e publikut, veçanërisht pas paralajmërimit zyrtar të KQZ-së për dështimin e sistemit elektronik të rezultateve preliminare, K-Vote, pak orë pas mbylljes së votimeve.

Një ditë pas Ditës së Zgjedhjeve, KQZ ende nuk ka dhënë informacione lidhur me fillimin dhe ecurinë e procesit të numërimit të votave të kandidatëve në Qendrat Komunale Zgjedhore, një procedurë e re e implementuar pas ndryshimeve në Ligjin për Zgjedhjet e Përgjithshme.

### **Rezultatet preliminare**

Dalja e përgjithshme e votuesve deri në mbyllje të vendvotimeve ishte 44.1%, me margjinë gabimi +/- 0,84%. Dalja e votuesve përgjatë intervaleve të caktuara kohore ishte si vijon:

- Deri në ora 12:00 – 14%;
- Deri në orën 17:00 – 38.9%;
- Deri në orën 19:00 – 44%.

Sipas të dhënave të raportuara nga vëzhguesit e DnV-së në terren, rezultatet preliminare, pa përfshirë votat me kusht, votat nga jashtë vendit dhe votat e personave me nevoja të veçanta, rezultatet e subjekteve politike janë si në vijim:

- Lëvizja Vetëvendosje – LVV 40,4% (Margjina e gabimit +/-1,44%)
- Partia Demokratike e Kosovës – PDK 21,7% (Margjina e gabimit +/-1,45%)
- Lidhja Demokratike e Kosovës – LDK 17,5% (Margjina e gabimit +/-0,97%)
- Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës AAK- NISMA 7,2% (Margjina e gabimit +/-0,82%)
- Koalicioni për Familjen 2,4% (Margjina e gabimit +/-0,21%)
- Srpska Lista - SL 5,4% (Margjina e gabimit +/-1,68%)
- Za Slobodu, Pravdu i Opstanak – SPO 0,6% (Margjina e gabimit +/-0,19%)



## Drejtësia zgjedhore

Drejtësia zgjedhore në Kosovë gjatë zgjedhjeve parlamentare të 9 shkurtit 2025 u karakterizua nga një numër i madh ankesash dhe ndërhyrje të Panelit Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP). Fushata zgjedhore, e cila zgjati nga 11 janari deri më 8 shkurt, u shoqërua me tubime të shumta elektorale, ku në shumë raste u përdor një gjuhë e ashpër, shpesh e cilësuar si nxitëse dhe urrejtëse. Përveç kësaj, u evidentuan shkelje të shumta të rregullave zgjedhore, si përdorimi i burimeve publike për qëllime elektorale, përfshirja e fëmijëve në tubime politike, pengimi i gazetarëve dhe vendosja e materialeve zgjedhore në hapësira të ndaluara.

Deri më 8 shkurt 2025, në PZAP u dorëzuan mbi 400 ankesa mbi shkeljet e Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme dhe rregulloret për administrimin e fushatës zgjedhore. Në përgjithësi, PZAP nxori 222 vendime, nga të cilat 125 ishin aprovuese dhe 97 refuzuese. Për shkeljet e konstatuara, u shqiptuan gjoba në një total prej 654,500 euro ndaj partive politike dhe kandidatëve të tyre. Partitë më të gjobitura ishin Lëvizja Vetëvendosje me 202,500 euro, PDK me 143,500 euro, LDK me 141,600 euro dhe AAK-NISMA me 81,200 euro. Gjobat u lidhën kryesisht me përdorimin e gjuhës nxitëse dhe të urrejtjes (315,000 euro), vendosjen e materialeve zgjedhore në hapësira publike (239,500 euro) dhe përdorimin e burimeve publike (72,500 euro). Gjithashtu, përfshirja e fëmijëve në fushatë u dënua me 16,500 euro gjobë, ndërsa në dy raste të pengimit të gazetarëve, PZAP shqiptoi 8,000 euro gjobë.

### **Analiza e vendimeve të PZAP**

Megjithatë, shqyrtimi i vendimeve të PZAP evidentoi mospërputhje në mënyrën e shqiptimit të dënimeve. Në raste të ngjashme të përdorimit të gjuhës së urrejtjes, gjobat varionin dukshëm, si në rastet A.nr.27/25, A.nr.20/25 dhe A.nr.30/25, ku subjektet politike u dënuan për të njëjtën shkelje me 12,000, 20,000 dhe 3,000 euro. Kjo tregon mungesën e konsistencës në vendimet e PZAP, duke lënë hapësirë për interpretime të ndryshme nga panelet e tij. Një situatë e ngjashme u has edhe në vendimet për përdorimin e burimeve publike dhe vendosjen e materialeve zgjedhore në hapësira të ndaluara. Për shembull, në rastin A.nr.48/25 një subjekt politik u dënua me 4,000 euro për vendosje posterësh në objekte publike, ndërsa për një shkelje identike, në rastin A.nr.51/25 një subjekt tjetër u ndëshkua me 5,500 euro. Po ashtu, në rastin e përdorimit të burimeve publike për mbajtjen e tubimeve, një subjekt u dënua fillimisht me 6,000 euro, ndërsa një tjetër për të njëjtën shkelje u ndëshkua me 8,000 euro.

Një tjetër dukuri e hasur gjatë vendimmarrjes ishte mungesa e standardeve të qarta për përcaktimin e gjuhës nxitëse dhe të urrejtjes. Në disa raste, termi "mashtues" është interpretuar si shkelje e ligjit, ndërsa në raste të tjera nuk është konsideruar si e tillë. Këto mospërputhje tregojnë për nevojën e një qasjeje më të unifikuar në interpretimin e rregullave nga PZAP.

Një numër i konsiderueshëm vendimesh të PZAP u ankuan në Gjykatën Supreme, e cila në disa raste vendosi anulimin e tyre për shkak të mungesës së provave të qarta ose për lartësinë disproporcionale të gjobave. Një rast i tillë ishte ai i Koalicionit për Familje, ku Gjykata Supreme konstatoi se deklaratat e kandidatëve të këtij subjekti nuk përbënin rrezik të drejtpërdrejtë për sigurinë e ndonjë grupi dhe duhet të konsideroheshin brenda kufijve të lirisë së shprehjes. Në vendimin e saj, Gjykata theksoi se legjislacioni në Kosovë ende nuk e njeht martesën brenda të njëjtës gjini, prandaj deklaratat në lidhje me këtë çështje nuk mund të konsiderohen nxitje për urrejtje. Për këtë arsye, vendimet përkatëse të PZAP u anuluan.

Vendime të ngjashme u anuluan edhe në rastin e gjobave ndaj LDK-së, ku Gjykata Supreme argumentoi se procesi në PZAP nuk ishte i mbështetur në prova të qarta dhe bindëse për shkeljet e konstatuara. Megjithatë, edhe vendimmarrja e Gjykatës Supreme nuk ishte gjithmonë uniforme. Në disa raste,



ankesat ndaj gjobave për gjuhë të urrejtjes u refuzuan si të pabazuara, ndërsa në raste të tjera u pranuan dhe vendimet e PZAP-it u anuluan. Kjo mospërputhje u vu re kryesisht në proceset ankimuese të Koalicionit për Familje dhe Lidhjes Demokratike të Kosovës, ku panelet gjyqësore të Gjykatës Supreme nuk mbajtën një linjë të qartë dhe të njëtrajtshme në vendimmarrje.

### **Trajtimi i Ankesave në Gjykatë Supreme**

Pavarësisht se PZAP kishte shqiptuar një numër të madh gjobash ndaj subjekteve politike, disa prej këtyre vendimeve u ankimuan në Gjykatën Supreme, kryesisht për shkak të mungesës së arsytimit të duhur dhe lartësisë së dënimeve. Në të paktën dy raste, vendimet dënuese për gjuhë nxitëse ndaj subjektit politik Koalicioni për Familje u anuluan nga Gjykata Supreme (shih rastet AA.nr.31/25 dhe A.nr.33/25). Sipas Gjykatës, këto vendime nuk ishin të bazuara në dëshmi të qarta apo prova konkrete që tregonin për nxitje të urrejtjes. Gjykata argumentoi se disa shprehje retorike të përdorura nga kandidatët e këtij subjekti nuk kishin rrezikuar sigurinë fizike të komunitetit LGBT dhe nuk përbënin denigrim të drejtpërdrejtë ndaj askujt, por ishin deklarime programore brenda suazave të lirisë së shprehjes. Për më tepër, Gjykata theksoi se, sipas legjislacionit në Kosovë, martesa është e lejuar vetëm mes dy gjinive të kundërta, ndaj nuk mund të konsiderohej se kjo e drejtë ishte cenuar.

Gjithashtu, disa vendime dënuese ndaj subjektit politik Lidhja Demokratike e Kosovës u anuluan nga Gjykata Supreme, me arsytimin se në procesin e PZAP nuk ishin argumentuar në mënyrë bindëse shkeljet e kryera (shih vendimin AA.nr.40/25).

Megjithatë, ndonëse Gjykata Supreme anuloi disa vendime të PZAP-it, u vërejt se edhe kjo gjykatë nuk kishte ndjekur një linjë të njëjtë në trajtimin e rasteve të shkeljeve të ngjashme nga subjektet politike. Në situatat kur bëhej fjalë për dënime për gjuhë nxitëse dhe urrejtëse, disa ankesa u refuzuan si të pabazuara, ndërsa në raste të tjera, vendimet e PZAP-it u anuluan.

Konkretisht, kjo mungesë uniformiteti u pa në proceset ankimuese të Koalicionit për Familje dhe Lidhjes Demokratike të Kosovës, ku vetë panelet gjyqësore të Gjykatës Supreme nuk mbajtën qëndrime të njëtrajtshme në vendimet e tyre. Kjo tregon për nevojën e një qasjeje më konsistente në trajtimin e rasteve të shkeljeve zgjedhore, për të siguruar barazi dhe drejtësi në procesin e vendimmarrjes.

---

*Koalicioni i organizatave vendore të shoqërisë civile për vëzhgimin e zgjedhjeve "Demokracia në Veprim" ka angazhuar rreth 700 vullnetarë për të vëzhguar në procesin zgjedhor për zgjedhjet parlamentare, të mbajtura më 9 shkurt 2025.*

*Fushata parazgjedhore është vëzhguar nga 44 vëzhgues të akredituar afatgjatë të DnV-së, të cilët kanë përcjellë tubimet publike në të gjitha komunat, duke përfshirë edhe zonat e banuara me shumicë serbe.*

*DnV ka monitoruar edhe mbledhjet e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve dhe Komisioneve Komunale Zgjedhore. Në ditën e zgjedhjeve, DnV ka pasur të angazhuar mbi 600 vullnetarë, prej të cilëve 500 janë vendosur nëpër vendvotime sipas metodologjisë PVT, si dhe 50 vëzhgues të tjerë në cilësi të ekipeve mobile duke përcjellur atmosferën e përgjithshme në Qendrat e Votimit dhe jashtë tyre. Ndërsa, rreth 50 vullnetarë të tjerë janë angazhuar në Qendrën e Thirrjeve, përmes së cilës DNV ka mbledhur, procesuar dhe analizuar të dhënat e marra nga terreni.*

*DnV do të përcjellë edhe procesin e numërimit në qendrat komunale të numërimit, si dhe në Qendrën e Numërimit të Rezultateve. Po ashtu, do të mbulohet edhe drejtësia zgjedhore, përfshirë shqyrtimin e ankesave eventuale në Panelin Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia apo në Gjykatën Supreme, deri në certifikimin përfundimtar të rezultateve.*

*Të gjeturat e detajuara nga procesi i vëzhgimit para, gjatë dhe pas ditës së zgjedhjeve, do të paraqiten në raportin përfundimtar të vëzhgimit, i cili do të publikohet pas certifikimi të rezultateve.*





*DnV është e përkushtuar të kontribuojë në rritjen e integritetit të procesit zgjedhor përmes vëzhgimit dhe raportimit të rregullt, të paanshëm dhe objektiv tek publiku. Misioni vendor i DnV-së për monitorimin e zgjedhjeve është mbështetur nga Ambasada e Zvicrës në Kosovë, Westminster Foundation for Democracy, dhe USAID Kosova.*